New York State of Opportunity. | Department of Motor Vehicles

# NDRYSHIMI I ADRESËS

Ndryshoni adresën tuaj online në dmv.ny.gov

Mund ta **ndryshoni adresën tuaj online** në dmv.ny.gov ose pranë zyrës vendore të DMV-së.

Sipas ligjit të shtetit të Nju-Jorkut, ju jeni i detyruar të njoftoni DMV-në brenda 10 ditësh për çdo ndryshim në adresën e PËRHERSHME, nëse keni një leje drejtimi të lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut, leje praktikanti ose kartë identiteti të jodrejtuesit, ose një regjistrim në shtetin e Nju-Jorkut për një automjet, varkë, ose motoslitë. MOS raportoni ndryshime adrese të përkohshme.

Mund ta ndryshoni adresën tuaj si pjesë të procesit të rinovimit të dokumentit. Plotësoni fushat e adresës suaj të re në njoftimin e kujtesës, ose përditësoni adresën tuaj në llogarinë tuaj MyDVM. Për informacion se si të ndryshoni adresën tuaj online, vizitoni dmv.ny.gov/address-change.

Nuk është e nevojshme të merrni leje praktikanti, kartë identiteti të jodrejtuesit, dokument regjistrimi, ose leje drejtimi të re, por gjithsesi ofrohet opsioni i marrjes së një dokumenti të ri.

**Nëse dëshironi një dokument të ri:**

1. Plotësoni pjesën 1 dhe pjesën 2 në faqen 2 të këtij formulari.
2. Vendosni nënshkrimin tuaj në seksionin "Vërtetimi".
3. Paraqitni një kopje (të faqes para dhe mbrapa) të lejes së drejtimit/lejes për praktikantë/kartës së identifikimit të jodrejtuesit aktuale, të vlefshme, të lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut ose të ID-së së shërbimit ushtarak.
4. Plotësoni një çek ose urdhërtransfertë të pagueshme për "Komisionerin e Mjeteve Motorike" për të gjithë tarifën.
5. Dërgoni me postë formularin e plotësuar dhe mandatin e pagesës në adresën: **NYS DMV License Production Bureau**<br>**PO Box 2895**<br>**Albany, NY 12220-0895**
6. **Ruani dokumentin(et) tuaj aktual derisa të merrni dokumentin e ri/dokumentet e reja** me postë brenda 4 deri në 6 javëve. Nëse kërkoninjë leje praktikanti, kartë identiteti ose leje drejtimi ose dokument të ri special ose të posaçëm identifikimi (leje drejtimi), adresa juaj e banimit do të shfaqet në dokument dhe dokumenti do të dërgohet me postë në adresën tuaj postare. Nëse kërkoni një leje drejtimi, leje për praktikantë, ose kartë identifikimi standarde, adresa juaj postare do të shfaqet në dokumentin tuaj.

**Nëse NUK doni të merrni një dokument të ri:**

1. Plotësoni pjesën 1, por mos e plotësoni pjesën 2. DMV-ja do të përditësojë të dhënat tuaja në DMV pa asnjë kosto.
2. Përditësoni adresën tuaj në lejen e drejtimit, lejen e praktikantit ose kartën e identitetit të jodrejtuesit të shtetit të Nju-Jorkut dhe në dokumentin tuaj të regjistrimit në shtetin e Nju-Jorkut. Për të përditësuar adresën tuaj, shkruani adresën e re me bojë që nuk fshihet direkt në anën e pasme të dokumentit, në kutinë"Shkruani ndryshimin e adresës". Për regjistrime, hiqini një vizë adresës së vjetër dhe vendosni adresën e re në pjesën e parme.
3. Paraqitni një kopje (të faqes para dhe mbrapa) të lejes së drejtimit/lejes për praktikantë/kartës së identifikimit të jodrejtuesit aktuale, të vlefshme, të lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut ose të ID-së së shërbimit ushtarak.

Nëse ndryshoni adresën tuaj dhe nuk keni paguar gjobat për shkeljet e rregullave të qarkullimit në qytetin e Nju-Jorkut, duhet të telefononi Byronë për Shkeljet e Rregullave të Qarkullimit (Traffic Violations Bureau) në numrin (718) 488-5710. Përgatituni që të jepni adresën tuaj të re dhe të paguani gjobat. Për më shumë informacion, vizitoni dmv.ny.gov/tvboffice.htm.

## INFORMACIONI NË APLIKIMIN PËR REGJISTRIMIN E VOTUESVE NË SHTETIN E NJU-JORKUT

*(Ju lutemi lexoni përpara se të plotësoni Aplikimin për Regjistrimin e Votuesve në Shtetin e Nju-Jorkut në faqen 2.)*

OFFICE USE ONLY

**Përdorni Aplikimin për Regjistrimin e Votuesve në Shtetin e Nju-Jorkutpër të votuar në zgjedhjet në shtetin e Nju-Jorkut dhe/ose:**

- për të ndryshuar emrin ose adresën në regjistrin e votuesve
- për t'u anëtarësuar në një parti politike
- për të ndryshuar anëtarësimin në parti
- për t'u regjistruar paraprakisht për të votuar, nëse jeni 16 ose 17 vjeç

**Për t'u regjistruar, duhet të plotësoni këto kërkesa:**

- të jeni shtetas amerikan
- të jeni 18 vjeç (mund të regjistroheni paraprakisht në moshën 16 ose 17 vjeç, por nuk mund të votoni derisa të mbushni 18 vjeç)
- të mos jeni në duke vuajtur dënim me burg për një vepër penale
- të mos kërkoni të drejtën e votës diku tjetër
- të mos jeni konstatuar i paaftë nga një gjykatë

Información en español: si le interesa obtener este formulario en español, llame al 1-800-367-8683

中文資料:若您有興趣索取中文資料表格,請電: 1-800-367-8683

한국어: 한국어 양식을 원하시면 1-800-367-8683 으로 전화 하십시오.

যদি আপনি এই ফর্মটি বাংলাতে পেতে চান তাহলে 1-800-367-8683 নম্বরে ফোন করুন

Nëse nuk e plotësoni Aplikimin për Regjistrimin e Votuesve në Shtetin e Nju-Jorkut, do të konsiderohet se keni refuzuar të regjistroheni për të votuar. Nëse refuzoni të regjistroheni për të votuar, ky fakt do të mbetet konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllime të regjistrimit të votuesve. Nëse regjistroheni për të votuar, zyra në të cilën dorëzoni një aplikim për regjistrimin e votuesve do të mbetet konfidenciale dhe do të përdoret vetëm për qëllime të regjistrimit të votuesve. Nëse besoni se dikush ka ndërhyrë në të drejtën tuaj për t'u regjistruar apo refuzuar regjistrimin për të votuar, në të drejtën tuaj për ruajtjen e privatësisë në lidhje me vendimin nëse do të regjistroheni ose në aplikimin për t'u regjistruar për të votuar, ose në të drejtën tuaj për të zgjedhur partinë tuaj politike ose preferenca të tjera politike, mund të paraqitni një ankesë pranë Bordit të Zgjedhjeve të shtetit të Nju-Jorkut (New York State Board of Elections), 40 North Pearl Street, Albany, NY 12207-2729 (telefon:1-800-469-6872).

Aplikimi juaj i plotësuar do t'i dërgohet Bordit të Zgjedhjeve dhe ju do të njoftoheni nga Bordi i Zgjedhjeve i Kontesë kur aplikimi të jetë përpunuar. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me plotësimin e aplikimit për regjistrimin e votuesve ose regjistrimin për të votuar, duhet të telefononi Bordin e Zgjedhjeve të Kontesë ose numrin 1-800-PER-VOTE (për shërbimet TDD/TTY shkruani 711) (vetëm për pyetjet në lidhje me regjistrimin e votuesve). Nëse jetoni në qytetin e Nju-Jorkut, duhet të telefononi 1-866-VOTE-NYC. Gjithashtu, mund të gjeni përgjigje ose mjete në faqen e internetit të Bordit të Zgjedhjeve të Shtetit të Nju-Jorkut (New York State Board of Elections) www.elections.ny.gov

# NDRYSHIMI I ADRESËS

Ndryshoni adresën tuaj online në dmv.ny.gov

## PJESA 1 - Plotësoni këtë seksion për të NDRYSHUAR ADRESËN TUAJ

**Jepni informacionin në pjesën 1 që është i vlefshëm për llojin e dokumentit që dëshironi të përditësoni. Shënoni kutinë për çdo lloj dokumenti që keni dhe që duhet ndryshuar për të dëshmuar adresën tuaj të re. Duhet të përfshini një kopje (të faqes para dhe mbrapa) të lejes së drejtimit/lejes për praktikantë/kartës së identifikimit të jodrejtuesit aktuale të vlefshme të lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut ose të ID-së së shërbimit ushtarak.**

☐ Dokument standard ☐ Dokument special identifikimi ☐ Dokument i posaçëm identifikimi ☐ Regjistrimi

**E RËNDËSISHME:** Nëse jeni regjistruar për të votuar, të dhënat tuaja të regjistrimit si votues do të përditësohen kur të plotësoni dhe dorëzoni këtë formular. Nëse NUK dëshironi që adresa juaj e re të përfshihet në të dhënat tuaja të regjistrimit të votuesve, shënoni këtë kuti ☐. Nëse nuk e shënoni kutinë, adresa juaj e re do t'i dërgohet Bordit të Zgjedhjeve të kontesë së vendbanimit tuaj.

### LEJA E DREJTIMIT/LEJA E PRAKTIKANT/KARTA E IDENTITETIT E JODREJTUESIT:

| | |
|---|---|
| *Shkruani numrin e ID-së së lejes së drejtimit/lejes së praktikantit/kartës së identitetit të jodrejtuesit të lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut.* → | NUMRI I TELEFONIT |
| EMRI *(Emri juaj me germa të mëdha - mbiemri, emri, emri i mesit)* | DATËLINDJA ☐ M ☐ F ☐ X |

**ADRESA E RE** - KU MERRNI POSTËN (***E detyrueshme*** *- Përfshini numrin dhe emrin e rrugës, postën rurale, numrin e apartamentitdhe/osenumrin e kutisë postare. Gjithashtu, plotësoni adresën e vendbanimit më poshtë.)*

| QYTETI OSE QYTEZA | SHTETI | KODI POSTAR | KONTEJA | ☐ Shënoni këtë kuti nëse adresa ku merrni postën është e njëjtë me adresën ku jetoni. (Nëse e shënoni këtë kuti, mos plotësoni fushat "Adresa e re - Ku banoni". Shkoni te rreshti "Adresa e mëparshme në shtetin e Nju-Jorkut".) |
|---|---|---|---|---|

**ADRESA E RE** – KU BANONI (***Kërkohet nëse është e ndryshme nga adresa ku merrni postën*** *- MOS JEPNI NUMRIN EKUTISË POSTARE. Përfshini numrin dhe emrin e rrugës dhe numrin e apartamentit)*

| QYTETI OSE QYTEZA | SHTETI | KODI POSTAR | KONTEJA |
|---|---|---|---|

| ADRESA E MËPARSHME NË SHTETIN E NJU-JORKUT *(Përfshini numrin dhe emrin e rrugës, postën rurale, numrin e apartamentitdhe/ose numrin e kutisë postare.)* | QYTETI OSE QYTEZA | KONTEJA |
|---|---|---|

### REGJISTRIMI: *Jepni informacionin e mëposhtëm për çdo regjistrim në **emrin** tuaj që dëshironi të përditësoni në adresën tuaj të re.*

| Nr. i targës | Lloji i regjistrimit *(Shënoni një kuti)* | Pronar/regjistrues i ndryshëm* |
|---|---|---|
| | ☐ Pasagjeri ☐ Tregtare ☐ Motoslitë ☐ Varkë ☐ Tjetër *(Specifikoni)* | ☐ |
| | ☐ Pasagjeri ☐ Tregtare ☐ Motoslitë ☐ Varkë ☐ Tjetër *(Specifikoni)* | ☐ |
| | ☐ Pasagjeri ☐ Tregtare ☐ Motoslitë ☐ Varkë ☐ Tjetër *(Specifikoni)* | ☐ |

* Do të përditësohen edhe të dhënat e certifikatës së pronësisë **NËSE** ato lëshohen në të njëjtin emër regjistruesi. Shënoni kutinë për çdo regjistrim ku **emri** juaj shfaqet gjithashtu në certifikatëne pronësisë, por emri (emrat) në regjistrim dhe pronësia nuk përkojnë saktësisht. Për shembull, regjistrimi është vetëm në emrin tuaj, por pronësia është lëshuar në dy emra.

**VËRTETIM:** Vërtetoj se jam individi i përmendur më lart dhe se, në dijeninë time, informacioni i dhënë është i vërtetë.

Nënshkruani këtu: **X** ______________________ ______________

*Nënshkruani emrin e plotë* Data

**KUJDES!** Dhënia me vetëdije e informacionit të rremë në këtë formular përbën kundërvajtje dhe do të rezultojë në gjoba të autorizuara me ligj.

## PJESA 2 Plotësoni këtë seksion për MARRJEN E NJË DUPLIKATE QË TREGON ADRESËN TUAJ TË RE

Shënoni kutinë për çdo lloj dokumenti që keni aktualisht dhe që dëshironi të përditësoni për të shfaqur adresën tuaj të re. Më pas, paguani tarifën(at) e plotë me anë të një çeku që ka të shtypur paraprakisht emrin e titullarit të llogarisë ose një urdhërtransfertë të pagueshme për “Komisionerin e Mjeteve Motorike”.

☐ Leje drejtimi (tarifa: 17,50 $) ☐ Leje e praktikantit (tarifa: 17,50 $) ☐ Kartë identiteti e jodrejtuesit (tarifa: 8,00 $)*

☐ Regjistrimi (tarifa: 3,00 $ për regjistrim) ☐ Regjistrimi i varkave (tarifa: 2,00 $ për regjistrim) (mos e zgjidhni nëse po kërkoni një dokument të lejes së drejtimit)

*Vizitoni dmv.ny.gov/offices për më shumë informacion rreth mënyrës se si të përpunoni regjistrimin e motoslitës në kontenë ku banoni.*

* **Informacion shtesë lidhur me zëvendësimin e një karte identiteti jodrejtuesi:**
- Nëse jeni 62 vjeç **OSE** përfitues i të ardhurave shtesë nga sigurimi, tarifa është 6,50 $.
- Nëse jeni 62 vjeç **DHE** përfitues i të ardhurave shtesë nga sigurimi, nuk aplikohet asnjë tarifë.
- Nëse jeni përfitues i të ardhurave shtesë nga sigurimi, duhet të paraqitni dëshmitë përkatëse në këtë formular.
- Pas datës 1 tetor 2020, nuk do të aplikohet asnjë tarifë për përfituesit e ndihmës shtetërore. Duhet të paraqitni dëshmi në këtë formular.

## PJESA 3 APLIKIMI PËR REGJISTRIMIN E VOTUESVE NË SHTETIN E NJU-JORKUT

Plotësoni këtë aplikim nëse dëshironi të regjistroheni për të votuar ose të përditësoni informacionin tuaj të regjistrimit të votuesit në Bordin e Zgjedhjeve.

| | |
|---|---|
| A jeni shtetas i SHBA-ve? ☐ Po ☐ Jo<br>*Nëse përgjigjeni JO, nuk mund të regjistroheni për të votuar.* | A do të jeni 18 vjeç ose më shumë datën e zgjedhjeve ose para kësaj date? ☐ Po ☐ Jo<br>A jeni të paktën 16 vjeç dhe e kuptoni se duhet të jeni 18 vjeç datën e zgjedhjeve ose para kësaj date për të votuar dhe se deri sa të mbushni tetëmbëdhjetë vjeç në momentin e këtyre zgjedhjeve, regjistrimi juaj do të shënohet "në pritje" dhe nuk do të mund të votoni në asnjë zgjedhje? ☐ Po ☐ Jo<br>Nëse u përgjigjeni **JO** të dyja pyetjeve të mëparshme, nuk mund të regjistroheni për të votuar. |

| | | |
|---|---|---|
| Keni votuar më parë? ☐ Po ☐ Jo<br>Në cilin vit? | Informacioni juaj lidhur me votimin që ka ndryshuar:<br>Kapërcejeni nëse informacioni nuk ka ndryshuar ose nëse nuk keni votuar më parë. | Emri juaj ishte<br>Adresa juaj ishte<br>Shteti juaj ose konteja e shtetit të Nju-Jorkut ishte: |
| **Më shumë informacion (Opsionale)** | Emaili | Numri i telefonit |

**Parti politike**

**Duhet të zgjidhni 1. Regjistrimi në një parti politike është opsional, por, për të votuar në zgjedhjet paraprake të një partie politike, një votues duhet të regjistrohet në atë parti politike, përveçse kur lejohet ndryshe nga rregullat e partisë.**

**Dëshiroj të regjistrohem në një parti politike:**

☐ Partia Demokratike
☐ Partia Republikane
☐ Partia Konservatore
☐ Partia e Familjeve Punëtore
☐ Tjetër:______________

**Nuk dëshiroj të regjistrohem në asnjë parti politike dhe dëshiroj të mbetem votues i pavarur**

☐ Asnjë parti

**DEKLARATË:** Betohem ose konfirmoj se
- Jam shtetas i Shteteve të Bashkuara.
- Do të kem jetuar në konte, qytet ose fshat të paktën 30 ditë para zgjedhjeve.
- I plotësoj të gjitha kërkesat për t'u regjistruar për të votuar në shtetin e Nju-Jorkut.
- Nënshkrimi ose shenja rreshtin më poshtë është i imi/e imja.
- Informacioni i mësipërm është i vërtetë. E kuptoj se nëse ky informacion nuk është i vërtetë, mund të dënohem dhe të gjobitem deri në 5000 $ dhe/ose të dënohem me burg deri në katër vjet.

Nënshkrimi **X** ______________________ Data ______________

Rivendos/Pastro